



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I TIRANËS
FAKULTETI I GJUHËVE TË HUAJA
DEPARTAMENTI I GJUHËS SPANJOLLE



PROGRAMI MËSIMOR I LËNDËS
Përkthim Letrar

Ngarkesa: Numri i krediteve: 3 (tre); 30 orë mësimore (10 orë leksione, 20 orëseminare)

Viti semestri kur zhvillohet: Viti II , Semestri i parë

Lloji i lëndës: Lëndë e detyrueshme

Programi i studimit: Master i Shkencave në “Përkthim Teknik - Letrar dhe Interpretim”

Kodi i etikës: Kodi i etikës i UT-së (nenet 4, 6, 7, 9)

PËRMBLEDHJET DHE REZULTATET E TË NXËNIT:

Objektivat e përgjithshëm lëndorë:

Gjatë këtij kursi studentët trajtojnë në mënyrë më pragmatike veçoritë e përkthimit të teksteve letrare, duke u përqendruar fillimisht tek tekstet rrëfimore dhe karakteristikat e tyre përkthimore, për të kaluar më pas tek tekstet poetike dhe veçantitë e tyre. Për këtë qëllim, do të propozohet një seri tekstesh mbi të cilat studentët do të punojnë, qoftë në mënyrë krahasuese, qoftë individualisht si detyra përkthimi. Kjo do t'u mundësojë studentëve t'i kushtojnë vëmendje faktorëve të ndryshëm (gjuhësorë, stilistikë, kulturorë...) që janë të pranishëm në përkthimin letrar.

Rezultatet e pritshme:

1. Kur flitet për kompetencat specifike të përkthimit, i referohemi një serie kapacitetesh, njohurish dhe aftësish që nevojiten për të përkthyer.
2. Është thelbësore të zhvillohen kompetencat dhe aftësitë specifike për të kompensuar mungesën e njohurive të specializuara mbi një temë të caktuar.
3. Këtu përfshihet kompetenca gjuhësore dhe jashtë gjuhësore ose kulturore, si dhe kompetenca strategjike e mbi të gjitha kompetenca komunikuese dygjuhësore e cila në thelb është aftësi për të komunikuar në tekste në gjuhë të ndryshme.
4. Kompetenca strategjike i jep përkthyesit aftësi të jetë efikas dhe të zgjidhë problemet që mund të lindin. Bëhet fjalë për të identifikuar problemet që mund të shfaqen gjatë përkthimit dhe për të vepruar në mënyrë logjike dhe të koordinuar.
5. Kompetenca profesionale lidhet me aftësinë e të organizuarit mirë të punës, ku përfshihet dhe përdorimi i teknologjisë dhe burimeve të reja të informacionit.
6. Përkthyesi duhet të zhvillojë kompetencën e komunikimit në grup me përkthyes të tjerë dhe me redaktorë, klientë, agjenci, etj.